



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 793/5 Prot.

Tiranë, më 15/10/2015

V E N D I M

Nr. 44, datë 15/10/2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" (i ndryshuar), si dhe neneve 80-104 të Ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", të procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Spitali Universitar i Traumës*", Tiranë,

V Ë R E J S E :

Në zbatim të Urdhrit Nr.175 datë 09/09/2015, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit e Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit, "*Spitali Universitar i Traumës*", me objekt:

- Plotësimi nga ana e kontrolluesit të detyrimit për informim (neni 18) të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" (i ndryshuar) dhe Udhëzimin Nr. 3, datë 05/03/2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*" (i ndryshuar).
- Plotësimi nga ana e kontrolluesit të detyrimit për njoftim (nenet 21, 22) të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" (i ndryshuar).

Kontrolluesi, gjatë ushtrimit të aktivitetit, mbledh, përpunon dhe ruan të dhëna personale dhe sensitive për subjektet e të dhënave të cilët kanë lidhje me aktivitetin e tij në fushën e shëndetësisë.

Nga hetimi administrativ i ushtruar pranë kontrolluesit, verifikimi në regjistrin elektronik të njoftimeve (të administruar nga K.D.I.M.D.P.) si dhe deklaratimet e përfaqësuesve të kontrolluesit, rezultoi se kontrolluesi "*Spitali Universitar i Traumës*" nuk e ka përmbushur detyrimin për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit në zbatim të nenit 21 të ligjit.

Gjatë kryerjes së hetimit administrativ, është konstatuar veprimi i një sistemi video-vëzhgimi (CCTV) në hyrje të territorit të kontrolluesit. Nëpërmjet verifikimeve përkatëse rezultoi se ky sistem i përket kompanisë "*Ales Shpk*" (Nipt K72117028D) e cila administron sigurinë e territorit të jashtëm, hyrjeve në ambientet e brendshme si dhe sigurinë fizike të personelit të kontrolluesit. Në kontratën përkatëse për delegimin e këtij shërbimi, është konstatuar se nuk është parashikuar vendosja e për këtë arsye mbikëqyrja e ambienteve me sistem video-

vëzhgimi (CCTV). Në përfundim të hetimit administrativ është konkluduar se ky sistem është vendosur nga kompania e sigurisë fizike me iniciativën e vet dhe me qëllim mbikëqyrjen e ambienteve dhe dokumentimin e incidenteve të mundshme. Në hyrje të territorit të "Spitalit Universitar të Traumës", janë konstatuar tabela informuese mbi prezencën e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV). Ndonëse nuk janë sipas modelit standard të miratuar nga K.D.I.M.D.P., ato janë vendosur në ambiente të dukshme.

Zyra e Komisionerit vlerëson se në kuadër të garantimit të sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nëpërmjet sistemit CCTV, është e nevojshme që kontrolluesi të hartojë rregulla specifike të shkruara mbi sigurinë e përpunimit, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e aksesit, afatet e mbajtjes së të dhënave personale të përpunuara nëpërmjet sistemit CCTV, etj, në zbatim të detyrimeve që parashikon Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" (i ndryshuar) dhe Udhëzimit nr. 3, datë 05/03/2010 "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" (i ndryshuar).

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverbali i konstatimit në momentin e ushtrimit të hetimit administrativ.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar si dhe në zbatim të neneve 93-96 të ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me shkresën nr. 793/3 prot. dt. 29/09/2015 është njoftuar kontrolluesi "Spitali Universitar i Traumës" për tu paraqitur pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit më datë 07/10/2015 ora 10:20, për tu dëgjuar në lidhje me pretendimet e mundshme.

Kontrolluesi "Spitali Universitar i Traumës" është paraqitur në datën dhe orën e përcaktuar dhe ka dorëzuar në cilësinë e provës kontratën e rinovuar me shoqërinë e cila përgjigjet për sigurinë fizike. Në kontratën e rinovuar konstatohet se është përfshirë mundësia e instalimit dhe përdorimit të sistemit të video-vëzhgimit (CCTV). Gjithashtu, kontrolluesi ka përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e përpunuesit si dhe e ngarkon këtë të fundit me përgjegjësinë për zbatimin e Ligjit nr. 9887 "Për Mbrojtjen e të dhënave personale" (i ndryshuar), Udhëzimit nr. 3 datë 05/03/2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" (i ndryshuar) dhe të gjitha detyrimeve ligjore në fuqi.

Në përmbajtje të kontratës nuk janë parashikuar rregulla mbi sigurinë teknike dhe organizative të të dhënave personale që përpunohen nëpërmjet sistemit CCTV, kushtet e përpunimit, të drejtat e aksesit, afati i mbajtjes së të dhënave etj, në zbatim të nenit 20 dhe 27 të ligjit.

Sipas Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (i ndryshuar), kontrolluesit kanë përgjegjësinë për përpunimin e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, e për pasojë, detyrimin e zbatimit e të gjitha kërkesave të këtij ligji, në mënyrë të veçantë, atë të detyrimit që parashikon paragrafi 1 i nenit 21: "...Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji".

Meqenëse kontrolluesi në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së tij në fushën e ofrimit të shërbimeve shëndetësore dhe në kuadër të veprimit të një sistemi video-vëzhgimi, konsiderohet se përpunon të dhëna personale, ka detyrimin ligjor që të njoftojë pranë Zyrës së Komisionerit në zbatim të nenit 21 të ligjit.

Nga verifikimi paraprak në Regjistrin elektronik të njoftimeve si dhe në protokollin e brendshëm të Autoritetit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, rezultoi se deri në momentin e kryerjes së hetimit administrativ kontrolluesi nuk kishte njoftuar. Kontrolluesi ka reaguar në datën 18/09/2015, mbas hetimit administrativ të ushtruar në vend (në datën 17/09/2015), duke paraqitur "Formularin e Njoftimit".

Bazuar në nenin 25/1 të ligjit, kontrolluesi nuk mund të fillojë përpunimin e të dhënave personale pa njoftuar më parë Zyrën e Komisionerit. Në këto kushte, konsiderohet shkelje serioze përpunimi i të dhënave personale, pa njoftuar dhe pa u regjistruar më parë, në Regjistrin Qendror të subjekteve kontrolluese, të administruar nga Zyra e Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se në kuadër të garantimit të sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nëpërmjet sistemit (CCTV), është e nevojshme që kontrolluesi të hartojë rregulla specifike të shkruara mbi sigurinë e përpunimit, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e aksesit, afatet e mbajtjes së të dhënave personale të përpunuara nëpërmjet sistemit (CCTV), etj, në zbatim të detyrimeve që parashikon Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" (i ndryshuar) dhe Udhëzimit nr. 3, datë 05/03/2010 "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" (i ndryshuar).

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit administrativ në kuptim të nenit 39/1 shkronja "d" të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" (i ndryshuar), përbëjnë "kundërvajtje administrative" dhe dënohen me gjobë.

Në dhënien e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato çënojnë të drejtën e subjekteve të të dhënave për tu informuar mbi mënyrën, qëllimin e përpunimit, masat e sigurisë, dhe të drejtat që kanë në zbatim të ligjit.

PËR KËTO ARSYE :

Në zbatim të neneve 29, 30, 31/1/"a/1" , 32, 39/1/d, 40 dhe 41 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" (i ndryshuar), si dhe nenet 107-109 të Ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë":

V E N D O S A

1. Dënimin e kontrolluesit "Spitali Universitar i Traumës", me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" (i ndryshuar).
2. Zbatimin e Udhëzimit nr. 3 datë 05/03/2010 "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" (i ndryshuar) dhe në veçanti:
 - Të hartohen rregulla specifike të shkruara mbi sigurinë e përpunimit, ruajtjen e konfidencialitetit dhe të drejtat e aksesit në sistemin (CCTV) (në zbatim edhe të nenit 27-28 të ligjit);
 - Të mos tejkalohet koha e ruajtjes së të dhënave (dy muaj) parashikuar në këtë Udhëzim;
 - Të dokumentohet përhapja e të dhënave imazhe-video ndaj palëve të treta ligj zbatuese si Prokurori, gjykatë, polici, etj.;

- *"Formati i tabelave informuese për kamerat"*, të vendoset në të gjitha ambientet e mbikëqyrura me kamera, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale (në zbatim edhe të nenit 18 të ligjit).
3. Zbatimin e Udhëzimit nr. 19, datë 03/08/2012 *"Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimit të një kontrate tip në rastet e këtij delegimi"*, në kuadër të parashikimit të rregullave mbi sigurinë teknike dhe organizative të të dhënave personale që përpunohen nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV), kushtet e përpunimit, të drejtat e aksesit, etj, në zbatim edhe të nenit 20 dhe 27 të ligjit.
 4. Në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* (i ndryshuar), të tregohet kujdes në vijimësi në përditësimin e *"Formularit të Njoftimit"* pranë Zyrës së Komisionerit.
 5. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* (i ndryshuar), të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij Vendimi. Të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale brenda një afati 30 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
 6. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e njoftimit, sipas nenit 40 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* (i ndryshuar) dhe nenit 18 të Ligjit nr. 49/2012 *"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"*.

Ky vendim u shpall sot më 15/10/2015.

